





BASHKIA
VORE



Raporti Teknik



NDERTIMI I RRJETIT KUZ,DOMJE



RELACION TEKNIK



OBJEKTI

OBJEKTI: NDËRTIMI I RRJETIT KUZ DOMJE

INVESTITOR

BASHKIA VORE

RELACION

OBJEKTI: NDËRTIMI I RRJETIT KUZ DOMJE

- Ndërtimi i rrjetit të KUZ DOMJE.
- I propozuar nga Ujësjiellësi Kanalizimeve Vorë.
- Është në zbatim të planeve të SHA Ujësjiellësi i Kanalizimeve për rritjen e shërbimit dhe cilësisë së jetës së banorëve të kësaj zone.
- Drejtoria Inxhinjerie ka kryer rikonicionimin në vënd zonës ku do të ndërtohet rrjeti KUZ.
- Janë hartuar planimetritë e gjëndjes faktike të zonës.
- Problematikat janë evidentuar dhe janë shoqëruar me matjetet përkatëse.

1. POZICIONIMI

Fshati Domje ndodhet 7-8 km në veriperendim të kryeqytetit. Në këtë zonë ndodhen rreth 300 familje me mesatarisht 1500 banorë. Në këtë zonë mungon rrjeti I kanalizimeve KUZ .

Ndërtimi i këtij rrjeti do të shërbejë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për banorët e zonës Fush Domje dhe banorët e lagjes “Kastrat” Domje.

2. Përshkrim i gjendjes ekzistuese

Banorët e kësaj zone nuk disponojnë rrjete të kanalizimeve , në këto kondita banorët kanë realizuar në mënyrë individuale shkarkimet e ujërave të zeza. Por pavarësisht përpjekjeve të banorëve për të dhënë zgjidhje situatës në disa lagje ujërat e zeza dalin në sipërfaqe duke shkaktuar ndotjen e mjedisit por dhe duke rrezikuar shëndetin e banorëve. Prandaj shikohet e domosdoshme ndërtimi i një rrjeti të mirëfilltë të kanalizimeve, i cili do të japë zgjidhje problemit të banorëve.



KUSHTET NATYRORE

Vora ndodhet ne kryqëzimin kryesor rrugor të Shqipërisë, ku lidhet Tirana me Durrësin dhe veriu me jugun e vendit. Kjo bashki përfshihet ne prefekturën e Tiranës e pozicionuar në gjërësinë gjeografike lindje: 20°13'29", perëndim:19°03'32".

Relievi është kodrior-fushorme shtrirje gjeografike 12.5km veri-jug dhe 6.2km në drejtimin lindje-perëndim. Bashkia Vore gjendet në lartësinë 75 metra mbi nivelin e detit, kodrat e bukura të veshura me ullinj, pemë e pyje janë relativisht në lartësinë 500 metra. Si mjedis jetësor bën pjesë në zonën mesdhetare, ndërsa si kat bimorë bën pjesë në katin e shkurreve mesdhetare. Historikisht rajoni ynë njihet për ullinj të shekullorë në shpatet dhe kodrat piktoreske, ku vend të rëndësishëm zënë vreshtat , pemtoret, pjeshka, thana, pjeshka kumbulla shega etj.

Ndërtim dhe strukturë gjeologjike të larmishme, tepër të ndërlikuar, me evolucion kompleks dhe jo të njëjtë ; Pasuri të larmishme minerare dhe me vlera industriale ; Reliev malor, me kontraste të mëdha,

Veprimtaria e dendur vullkanike dhe lëvizjet e reja tektonike i kanë dhënë relievit të Hasit konfiguracionin e sotëm që paraqitet mjaft interesant. Është reliev kodrinoro-malor me lartësi mesatare 400–500 m mbi nivelin e detit. Në mes shtrihet fushëgropa e Hasit (Krumës) e që rrethohet nga veriu, lindja e jugu me një rrjet kodrinoro-malor. Kjo fushëgropë me origjine fund ose se ka formë pak a shumë të sheshtë. Relievi i saj ulet gradualisht nga lindja drejt perëndimit. Si rezultat i veprimtarisë erozive të lumit të Krumës dhe degëve të shumta të tij kjo fushëgropë është e ndare në blloqe paralele. Këto blloqe njihen nga banoret me emrin “pod” që do të thotë rrafsh ose “plan”. Këto rrafshe emërtohen nga banorët sipas përroit që i ndan ose fshatrave që i përkasin, të tilla janë : Podi i Shahjës, Breshezës, Vranishtit, Zahrishtit ose Plani i Krumës, Nikoliqit, Patës etj.

Bashkia e Vorës është në pjesën qendrore të Shqipërisë dhe kufizohet në veri me Krujën, në lindje me bashkinë Kamëz, në Jug me bashkinë e Tiranë, në perëndim kufizohet me bashkinë e Shijakut dhe të Durrsit. Pozicioni gjeologjik e bën këtë bashki të jetë nyja lidhëse ose kryqi natyrorë, me veriun e Shqipërisë, me jugun dhe bregdetin Adriatik. Kjo bashki ndodhet 9 km larg Aeroportit të Rinasit. Ndodhet 16 km larg nga Tirana kryeqyteti i Shqipërisë dhe 18 km larg nga porti i Durrësit.

Klima e një vendi apo të një zone e përcaktojnë shumë tregues, por pozita gjeografike dhe relievi janë më kryesorët. Bashkia Vorë bën pjesë në ultësirën Bregdetare, në nënzonën e medhetare kodrinore juglindore. Klima mesdhetare me temperatura mesatare vjetore rreth 16°C. Në korrik temperatura mesatare është rreth 24 °C dhe në janar rreth 6°C. vSasia mesatare e rreshjeve është 1,297 mm

Faktorët kryesorë që kushtëzojnë zgjatjen e djellëzimit janë gjërësia gjeografike, vranësi, pozicioni i vëndit etj. Kjo bashki ka 331 me diell në vit, të shpërndara sipas muajve të vitit. Intensiteti i rrezatimit të muajve të vitit është më i lartë në muajin maj, ndërsa më i ulët në muajin Dhjetorë. Kjo tregon se atmosfera ne muajin maj dhe dhjetorë është më e pastër sesa në e në Janarë. Ndërsa rrezatimi i djellit e ka vlerën më të lartë në mësditë gjatë muajit Korrik.



Fig. 1-4 Foto të gjëndjes ekzistuese

3. Përshkrim i projektit

Projekti do të përfshijë ndërtimin e rrjetit kuz në fshatin Domje. Ky rrjet kalon në shtëpitë e banorëve e zonës. Për ndërtimin e këtij rrjeti do të përdoren tubacione HDPE /SN8 ϕ 200, ϕ 315, ϕ 400. Gjithashtu përgjatë rrjetit do të ndërtohen puseta kontrolli, përmasat e të cilave do të jenë në varësi të kuotave të projektit.

Pusetat do të jenë të ndara në kategori:

- Puseta betoni H=1-2m, D=1m + kapak gize
- Puseta betoni H=2-3.5m, D=1.5m + kapak gize
- Puseta betoni H=3.5-4.5m, D=2m + kapak gize

Projekti për “**Ndërtim i rrjetit KUZ DOMJE**” do të hartohet në përputhje me kërkesat e kësaj detyre projektimi dhe kushteve teknike të projektimit (KTP) dhe zbatimit (KTZ).

Në detyrën e projektimit të hartuar nga Autoriteti Kontraktor për hartimin e projektit KUZ janë përcaktuar dy lagje; lagje Fushe Domje dhe Lagje Kastrati. Në vizitën e kryer në terren, këshillimit me Autoritetin Kontraktor dhe bisedës së kryer me banorët e zonës së lagjes Kastrati konstatuam se në lagjen e sipërcitur rrjeti KUZ ishte ekzistues. Ai ishte ndërtuar nga vetë investimet e banorëve. Në bisedës me banorët e zonës ishte pamundur ndërhyrja në rrjetin KUZ sepse ishte ekzistues dhe një investim privat.

Projekti përfundimtar do të përfshijë vizatimet, specifikimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara, relacionin përshkruar të punës së secilës disiplinë dhe preventivin e punimeve të parashikuara me cmime sipas manualit në fuqi. Dhe për zërat që nuk janë përfshirë në manual, ato të shoqërohen me analiza teknike perkatëse.